

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarës S.V., për shkak të veprës penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Kosovës KPK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda P.nr.22/2014 të datës 15.12.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, PAKR.nr.9/2017 të datës 06.06.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14 mars 2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarës S.V., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.22/2014 të datës 15.12.2016 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, PAKR.nr.9/2017 të datës 06.06.2017 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.22/2014 të datës 15.12.2016, e dënuara S.V., është shpallur fajtores për veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Kosovës KPK-së dhe është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj dhe për veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Kosovës KPK-së dhe është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, ashtu që i është shqiptuar dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj i cili dënim me pëlqimin e të dënuarës është shndërruar në dënim me gjobë në shumë prej 3600 (tremijë e gjashtëqind) €, të cilin dënim do të ekzekutohej 3 (tre) muaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nëse dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet i

njëti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke e llogaritur 1 (një) ditë burgimi me 20 (njëzet) € gjobë.

### **Vendimi i Gjykatës së Apelit**

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.9/2017 të datës 06.06.2017, ka aprovuar pjesërisht ankesën e mbrojtësit të të dënuarës dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.22/2014 të datës 15.12.2016, përkitazi me cilësimin juridik dhe vendimin për dënim, ashtu që ka gjetur se në veprimet e të dënuarës S.V., qëndrojnë vetëm elementet e veprës penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Kosovës KPK-së e të cilën e gjykoji me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet me kusht që e dënuara brenda afatit prej 1 (një) viti pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen veprë tjetër penale. Kurse ankesa e Prokurorit të Shtetit ishte refuzuar si e pabazuar.

### **Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë**

Kundër aktgjyqimeve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe Gjykatës së Apelit të Kosovës, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarës S.V., av. K.B., nga M., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuar të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë apo të dytë.

### **Mendimi i Prokurorit të Shtetit**

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me parashtresën KMLP.II.nr.170/2017 e datës 21.09.2017, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, të refuzohet si e pabazuar.

### **Pretendimet e ngritura në kërkesë**

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarës, pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë të përfshirë me shkelje të ligjit penal, përkatësisht mungon konstatimi për ekzistimin eventual të dashjes dhe formës së saj direkte apo eventuale si element subjektiv i kryerësit ndaj veprës penale, po ashtu dashja si formë e kryerjes së veprës penale duhet të theksohet në dispozitiv dhe nuk mjafton vetëm të konstatohet siç ka vepruar gjykata e shkallës së dytë kur ka konstatuar se vet qëllimi i përfitimit të dobisë pasurore për vete

nënkupton edhe dashjen. Më tutje theksohet se në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë theksohet se “...e akuzuara ka shpërdorë pozitën e saj dhe ka tejkalluar kompetencat, por kjo nuk nënkupton se e akuzuara akuzohet për dy forma të shpërdorimit ngase nga dispozitivi del qartë se ajo e ka shpërdorë pozitën e saj duke tejkalluar kompetencat e saja... ”, i cili konstatim nuk është i qëndrueshëm pasi që në rastet kur përfshihen në tekstin ligjor format alternative atëherë dispozitivi i aktgjykimit – përshkrimin faktik dhe cilësimin juridik nuk mund të qëndrojnë paralelisht dhe njëkohësisht siç është vepruar në rastin konkret, por duhet të përcaktohet njëra prej tyre. Në kontest të kësaj është theksuar se e dënuara nuk ka pasur rolin e personit vendimmarrës për lejimin e kredisë, por vetëm përgatitjen e lëndës dhe e cila punë është mbikëqyrë vazhdimisht nga komisioni për lejimin e kredive të “KEP-Trusti”.

Po ashtu sa i përket ekzistimit të veprës penale e paraparë me nenin 339 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, për të cilën është shpall fajtores e dënuara, element qenësor i kësaj vepre penale është që dëmi i shkaktuar të tejkallon shumën prej 2500 € dhe kjo është kontradiktore me dispozitivin e aktgjykimit e konstatuar edhe përmes aktgjykimit të shkallës së dytë “e akuzuara nuk ngarkohet me akuzë se i ka shkaktuar dëm institucionit ku ajo punonte”. Mbrojtësi i të dënuarës, po ashtu pretendon se në këtë çështje ka arritur afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale meqë kredia Loan nr. KOMI 00897-002, në emër të B.K., është akorduar me datë 20.10.2010 dhe kjo datë duhet të merret si datë e kryerjes së veprës penale dhe njëkohësisht datë e rrjedhjes së afatit të parashkrimit e jo siç është konstatuar gabimisht nga të dy gjykatat “...në muajin e pacaktuar të vitit 2011...” e me këtë edhe ka arritur afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

Në kërkesë pretendohet se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1.12 dhe par.2 nënpar.2.1 të KPRK-së, pasi që të dy aktgjykimet nuk janë përpiluar në kuptim të dispozitave të nenit 370 par.6 dhe 7 të KPPK-së. Aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë gjendjen e fakteve të cilën gjykata e ka vërtetuar në bazë të provave të administruara, përkatësisht në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë vetëm janë numëruar provat materiale, standardet juridike, ripërsëritur fjalët përfundimtare dhe mbrojtja e të dënuarës, pa bërë asnjë analizë të provave por vetëm konstatohet se “*Trupi gjykues ju dha besim të plotë dëshmisë së dëshmitares O.V. dhe B.K., pasi që këto deklaratat përputhen njëra me tjetrën kurse nuk i dha besim mbrojtjes së të akuzuarës S.V., me arsyetim se një mbrojtje e tillë është bërë me qëllim që e njëjta ti ki përgjegjësisë penale*” i cili konstatim është në kundërshtim me dispozitën e nenit 361 të

KPPK-së. E gjithashtu në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk janë paraqitur arsye për çdo pikë të aktgjykimit dhe nuk paraqitet në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, nuk vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, nuk jep arsye në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike e veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarës.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme**

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në pajtim me dispozitën e nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

*kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatoj se sa i përket pretendimeve të paraqitura nga mbrojtësi i të dënuarës, aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe atë për faktin se në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë mungon konstatimi për formën e kryerjes së veprës penale përkatësisht nuk është e qartësuar se vepra penale është kryer me dashje direkte apo eventuale. Dispozitivi është i paqartë edhe përkitazi me mënyrën e kryerjes së veprës penale përkatësisht në dispozitiv theksohet “ ...se akuzuara ka shpërdorë pozitën e saj dhe ka tejkaluar kompetencat”, e që me këtë rast është konstatim i cili nuk është i qëndrueshëm meqë ligjvënësi ka përcaktuar se kryerja e kësaj vepre penale kryhet në mënyrë alternative dhe mjafton njëra formë për tu kryer kjo vepre penale. Për më tepër dispozitivi i aktgjykimit është me alternativa, i paqartë dhe në kundërshtim të plotë me arsyetimin e dhënë.

Po ashtu, është i qëndrueshëm argumenti i paraqitur në kërkesë, se përshkrimi faktik në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë është në kundërshtim me emërtimin ligjor të veprës penale për të cilin është shpallë fajtores dhe është gjykuar e dënuara dhe atë me faktin se në dispozitiv përshkruhet se “...me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete dhe B.K.”, kurse dispozita e nenit 339 par.2 lidhur me par.1 të KPPK-së, përcakton formë të kualifikuar të kësaj vepre penale “...kur rezulton me dëm i cili tejkalon shumën prej 2500€...” e që sipas arsyetimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë dhe e pranuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë, në rastin konkret nuk bëhet fjalë për dëm të shkaktuar, bazuar në përshkrimin e dhënë në dispozitiv të aktgjykimit.

Aktgjykimi i shkallës së parë po ashtu përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.12 të KPPK-së, meqë nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 par.6 dhe 7 të KPPK-së.

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsytim për çdo pikë të aktgjykimit e po ashtu nuk ka arritur të arsyetoj se cilat fakte i konsideron të vërtetuara dhe cilat të pavërtetuara, por vetëm ka numëruar provat e prezantuara dhe nuk ka analizuar ato e për më tepër nuk ka vlerësuar provat kundërtënëse posaçërisht Raportin Kreditor i BQK-së i dt.04.01.2013, i cili vërteton se O.J., ka pasur cilësinë e garantuesit të huasë e aprovuar me datë 19.10.2010, por se nuk vërtetohet fakti se garantuesi ka nënshkruar dosjen e kredisë, e po ashtu nuk është vërtetuar se kush është përfituesi i kredisë. Po ashtu për përgjigjen e “KEP”-it në Prishtinë me nr. të protokollit 72/13 e dt.01.07.2013 potencohet fakti se nuk e posedojnë dosjen e kësaj kredie, meqë është djegur me rastin e zjarrvënies së degës së “KEP-Trustit” në Mitrovicë në mars të viti 2012. Ashtu që këto prova vetëm se janë përshkruar dhe nuk janë analizuar me provat e tjera e sidomos me dëshmitë e dëshmitarëve O.J. dhe B.K. e veçanërisht nuk është vlerësuar mbrojtja e të dënuarës e cila në të gjitha fazat e procedurës penale ka mohuar kryerjen e kësaj veprë penale.

Duke vepruar kështu, aktgjykimi i shkallës së parë, paraqet shkelje të dispozitës së procedurës penale nga neni 384 pa.1 nënpar.12 të KPPK-së dhe për këtë arsye u vendos që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të administroj provat ekzistuese e sipas nevojës edhe prova tjera e pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike. Fillimisht duhet të përcaktoj me saktësi kohën e kryerjes së veprës penale, meqë ka mbetur dilemë koha e saktë e kryerjes së veprës penale. Për më tepër, sipas provave materiale rezulton që kredia është aprovuar me datë 19.10.2010, e që mbetet e paqartë se mbi cilën bazë gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se vepra penale është kryer në muajin e pacaktuar të viti 2011 siç përshkruhet në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Më tutje duhet të harmonizoj dispozitivin e aktgjykimit me emërtimin ligjor të veprës penale dhe të konkretizoj se a kemi të bëjmë me përfitim të dobisë pasurore të të dënuarës dhe përfitueses së kredisë B.K, apo dëmtim të institucionit bankar përkatësisht “KEP-Trustit” në Mitrovicë, cila formë alternative e veprës penale pretendohet se është kryer shpërdorimi i pozitës zyrtare apo tejkalim i kompetencave,

e po ashtu si është bërë ndarja e parave nga kredia e marrë nga ana e B.K.t dhe të dënuarës S.V..

Nga këto arsye, kjo gjykatë konform nenit 438 par. 1 pika 1.2 të KPPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**

Pml.nr.198/17, më 15 mars 2018

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,

Valdete Daka